



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 118/9 prot.

Tiranë, më 30.9. 2022

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Lënda: Mbi Raportet e Monitorimit për 8-mujorin e vitit 2022

RELACION

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për 8-mujorin e vitit 2022. Zbatimi i këtij buxheti është mbështetur në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe është bazuar në parimin e ligjshmërisë, ekonomikitetit, efikasitetit dhe eficiencës së fondeve buxhetore. Në vijim paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, treguesit e realizimit të këtyre fondeve për periudhën 8-mujore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 8-mujor (plani)	Realizimi 8-mujor (fakti)	Realizimi në %
Shpenzime korente	73,728	74,735	49,638	48,348	97.4%
Shpenzime kapitale	2,000	600	600	432	72%
TOTALI	75,728	75,335	50,238	48,780	97%

Me ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", buxheti total i miratuar për Institucionin e Komisionerëve Publikë është 75,728 lekë, i ndarë në 66,128 mijë lekë në shpenzime personeli, 7,400 mijë lekë në shpenzime operative dhe 2,000 mijë lekë në investime.

Sikurse ju kemi bërë me dije edhe gjatë raporteve të kaluara të monitorimit të buxhetit, ashtu edhe në komunikime të tjera shkresore, ky buxhet, në zërat e shpenzimeve korente, përputhej me kërkesën e paraqitur në PBA 2022-2025, ndërkohë që buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte më i madh se nevojat.

Në vijim, buxheti i miratuar me ligj në fillim të vitit pësoi ndryshime me 2 akte normative.

Me aktin normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, ky buxhet u pakësua me 2,393 mijë lekë në shpenzime korente. Ky pakësim i buxhetit kishte efekt negativ në plotësimin e nevojave të institucionit në fushën e pagave, të cilat iu parashtruan Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ndërkohë, në muajin maj 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Vendimin nr. 37/2022, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë", me anë të të cilit u rritën pagat e punonjësve administrativë me 10%, si dhe u përcaktua kufiri maksimal i pagesave shtesë për shkak të vështirësisë, për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Në këto kushte, institucioni, në analizë të buxhetit në dispozicion dhe nevojave në shpenzime korente dhe investime, me shkresën nr. 6/34 datë 20.5.2022, i parashtroi MEF-së kërkesën për pakësimin e një pjese të fondit në investime dhe me shkresën nr. 6/37 datë 2.6.2022, nevojën për shtesë në fondin e pagave.

Këto kërkesa gjetën pasqyrim në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, nr. 12, datë 29.7.2022, më të cilin u pakësuan fondet në investime në vlerë 1,400 mijë lekë dhe, gjithashtu, u shtua fondi në shpenzime personeli me 3,400 mijë lekë.

Gjatë 8-mujorit janë kryer, gjithashtu, avancime të fondeve në shpenzime për paga dhe rialokim brenda shpenzimeve korente.

Vlera totale e buxhetit pas ndryshimeve arriti në 75,335 mijë lekë dhe, për 8-mujorin, në 50,238 mijë lekë. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë është në nivel të kënaqshëm, rreth 97%.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për 8-mujorin, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet si në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 8-mujor (plani)	Në mijë lekë	
					Realizimi 8-mujor (fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	66,128	69,975	46,178	45,970	99.5%
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	7,600	4,760	3,460	2,378	68.7%
231	Shpenzime kapitale	2,000	600	600	432	72%
	TOTALI	75,728	75,335	50,238	48,780	97%

1. Artikulli 600 dhe 601, "Shpenzime personeli", buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2022 për këtë zë është 66,128 mijë lekë, buxhet i cili do të mbulonte nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Gjatë këtij 8-mujori janë kryer pakësime dhe shtesa në artikujt buxhetorë nëpërmjet akteve normative në muajin prill dhe korrik, si dhe me qëllim mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore janë kryer avancime të fondeve dhe rishpërndarje e tyre, me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Siç jeni në dijeni, me Vendimin nr. 37/2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë". Këto ndryshime përfshijnë shtesën për kushte pune për punonjësit administrativë, si dhe shtesën për shkak të vështirësisë për Këshilltarët e Njësive të Shërbimit Ligjor. Për rrjedhojë, por edhe si rezultat i rritjes së pagës minimale në shkallë vendi, pagës maksimale dhe minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ishte e nevojshme që të rishikohej buxheti i vitit 2022.

Buxheti në paga dhe sigurime shoqërore, pas rishikimit, ka arritur në vlerën 69,975 mijë lekë, buxhet i cili është parashikuar të mbulojë pagat e punonjësve për gjithë vitin 2022, në rast se nuk do ketë ndryshime të tjera ligjore në fushën e pagave.

Performanca e realizimit të planit në këtë artikull buxhetor, për 8-mujorin e vitit 2022, është në nivelin 99.5%.

2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2022, është 7,400 mijë lekë, dhe pas rishikimit të buxhetit me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, dhe rialokimeve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, buxheti në shpenzime operative u pakësua me 2,840 mijë lekë, duke arritur në vlerën 4,760 mijë lekë.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për 8-mujorin e vitit 2022, është në nivelin 68.7%.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, materiale pastrimi, kancelari, tonera, si dhe procedura të thjeshtuara, blerje materiale dhe shërbime: blerje karburant, ujë i pijshëm, mirëmbajtje pajisje elektronike, mirëmbajtje e faqes *ëeb*, shpenzime larje automjeti, abonime në shtyp etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celulare, si dhe shpenzime të zakonshme, shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e Bashkisë etj.

Një pjesë e shpenzimeve të planifikuara janë rishikuar dhe do të rishikohen në vijim në kuadër të ekonomizimit të fondeve buxhetore, duke kryer rishpërndarje të tyre brenda shpenzimeve korente, për të plotësuar nevojat në fushën e pagave pas ndryshimeve të dispozitave ligjore, si dhe duke përcaktuar prioritetet për plotësimin e nevojave më të domosdoshme dhe më emergjente për mallra dhe shërbime.

Në periudhën e fundit të vitit 2022 synohet rritja e performancës së realizimit të fondeve buxhetore në këtë artikull buxhetor, pasi është parashikuar realizimi i disa zërave të Regjistrit të Parashikimit të Prokurimit Publik, si blerje tonera dhe *drume*, dhe materiale zyre e të përgjithshme.

Analitikisht, shpenzimet operative në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,283	749
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	1,315	1,194
3	Materiale dhe shërbime speciale	49	48
4	Shpenzime transporti + udhëtimi	230	139
5	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	294	105
6	Shpenzime të tjera speciale	89	83
	TOTALI	3,260	2,318

3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2022, është 2,000 mijë lekë, fond i cili tejkalonte kërkesën e institucionit për sa i përket këtij zëri të buxhetit, paraqitur kjo në Projektbuxhetin për periudhën 2022-2024, kërkesë e cila u kushtëzua nga përfundimi i mandatit kushtetues të institucionit.

Gjatë këtij 8-mujori, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe duke vlerësuar plotësimin e nevojave më emergjente për pajisje dhe mobilie zyre, me rreth 600 mijë lekë, duke marrë në konsideratë jetëgjatësinë e aseteve dhe mandatin kushtetues të institucionit, u kërkua rishikimi i buxhetit për vitin 2022 në shpenzime kapitale, i cili u pakësua me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.7.2022, me 1,400 mijë lekë.

Me buxhetin në shpenzime kapitale pas rishikimit janë blerë orendi zyre, me procedurë blerje me vlerë të vogël dhe në 4-mujorin e fundit të vitit synohet të rritet performanca e realizimit të këtij fondi, pasi është parashikuar që të plotësohen edhe disa nevoja emergjente për pajisje zyre.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime kapitale”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për 8-mujorin e vitit 2022, është në nivelin 72%.

Në përfundim vlerësojmë se buxheti i 8-mujorit të vitit 2022 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2022, duke synuar një performancë në rritje të realizimit të tyre, në të gjithë zërat e shpenzimeve, si dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për ecurinë e aktivitetit institucional.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues

Alketa Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 8 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	68,776	73,528	75,728	75,335	50,238	48,780	-1,458	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		68,776	73,528	75,728	75,335	50,238	48,780	-1,458	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		68,776	73,528	75,728	75,335	50,238	48,780	-1,458	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2022		Data	30.9.2022

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke


Emri i Grupit		Komisionerët Publikë					Kodi i Grupit	63
Programi		Veprimtaria e Komisionerit Publik					Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	(2) PBA Plan 2022	(3) Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 8 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	59,279	59,528	59,528	63,140	41,628	41,432	-196
601	Sigurime Shoqërore	6,465	6,600	6,600	6,835	4,550	4,538	-12
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,002	7,400	7,400	4,560	3,260	2,318	-942
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	30		200	200	200	60	-140
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	68,776	73,528	73,728	74,735	49,638	48,348	-1,290
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	0		2,000	600	600	432	-168
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	2,000	600	600	432	-168
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	2,000	600	600	432	-168
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		68,776	73,528	75,728	75,335	50,238	48,780	-1,458


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2022		Data	30.9.2022

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Komisioneret Publike	63
Programi	Veprimtaria e Komisioneret Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2021)	Shpenzimet (sipas vitit 2021)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2021)	Sasia (sipas planit te vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2022)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit 2022)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit 2022)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit 2022)	Sasia Faktike per 8 mujorin e vitit 2022	Shpenzimet Faktike per 8 mujorin e vitit 2022	Kosto per Njesi per 12 mujorin e vitit 2022	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
Produkti 1	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	nr. Çeshtjesh	171	68,776	402	160	73,728	461	160	74,735	467	65	48,348	744	85%	61%	59%		
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete punc	5	0	0	9	2,000	222	0	600	#DIV/0!	0	432	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!		
Totali				68,776	402	169	75,728	683	160	75,335	#DIV/0!	65	48,780	#DIV/0!				0		



Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	30.9.2022

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	30.9.2022

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 8 mujori 2022


Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komente	
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik							
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2021	Niveli i planifikuar ne vitin 2022	Niveli i rishikuar per 4 mujorin e vitit 2022	Niveli faktik per 4 mujorin e vitit 2022	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."								
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	171	160	160	65	41%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2022		Data	30.9.2022

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2022	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	-				600	432	432		Pakesuar fondi ne investime me AN nr.12/2022
M630013	Pajisje kompjuterike	-				-	-	-		Pakesuar fondi ne investime me AN nr.12/2022
TOTALI		-			-	600	432	432	-	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2022		Data	30.9.2022